

## Mbledhja e XXXIII

E Merkure me 14-X-1925, ora 10 pas dreke

### Mbledhjen e Kryeson Z. PANDELI EVANGELI

Këndohën emnat e ZZ. Senatorve dhe mungojn ZZ. E. Vlora (leje) I. Xhindi, Nafiz Dervishi, P. Sh. Deda (leje) S. Papa (misjon) Sh. Verlaci, Sami Vrioni, Sh. Serreqi (leje)

Z. KRYETARI. Shumica asht mbledhja hapet.

Këndohët shkresa e Kryesiës Këshillit Ministrer Nr. 1272-III. me 14-X-25 dhe ajo e Ministr. P. Jashtme Nr. 1924 me 12-X-1925 mbi shkenbimin e Monastirit të Shin-Naumit dhe mbi një Rektifikim të vogël të perendimit të Velopojës të projit Voçpotok.

Z. E. FRASHERI. Qeverija e sotshme me shkresen që na ka drejtuar naflet mbi Qeverin Demisionare, por nuk na thotë që a e pranon vet Qeverija e sotshme kët marrëveshtje?

Prandej duhet të vij Qeverija e të na thotë se a e pranon këtë marrëveshtje a jo, se Qeverija e parë ka dhanë dorëheqjen, e cila ka pas qenë Autorizue prej fuqis Legjislative për me hyenë marrëveshtje.

Z. A. DIBRA. E pranon Qeverija e po jo, do më et vesht në Mbledhjen e përbashkët ku do të vij Qeverija të na jap shkoqitje, une them për mos me humbun kohën t'apin vendim që të mblidhen të dy Dhomat së bashkut.

Z. S. VUÇETERNI. Si mbas dispozitive të Nenit 141 të Statutit, propomini për mbledhjen e përbashkët të dy Dhomave Legjislative, duhet të vinje a prej Kryetarit të Republikës ase prej Misave të Dhomave.

Pra mbasi proponimit për mbledhjen e dy Dhomave nuk u vjen prej anës Kryetari të Republikës, ase prej Misave, nuk mundet të mblidhen të dy Dhomat së bashku se asht kontra Stautit.

Z. A. DIBRA. Nuk duhet të vij propomimi prej Kryetarit të Republikës për arsyen së kishte ardhun shkresa prej anës Kryetari per mbledhjen e dy Dhomave në Korrik dhe kjo asht vazhdimi i atyne mbledhjeve.

## BISEDIMET E SENATIT

Veç kësaj shpirti i shtojcës që asht bamun në Statut, asht që shkembimi i tokavet të bahet si mbas dizpozitave të Nenit 141 të Statutit dhe jo për formalitet e mbledhjes se të dy Dhomave.

Z. S. VUÇTERNI. Une thaç që propozimi për mbledhjen e dy Dhomave lypset të jet në bazën e Nenit 141 të Statutit dhe jo për vendim.

Z. A. DIBRA. Parafolesi thote që propozimi asht i bëne prej anes se Kryesis në Korrik, edhe këtë mbledhje e quan vazhdimin e saj, dhe e dyta thotë që shpirti i shtojcës së Statutit asht që shkembimi i tokave lypset të bahet si mbas Nenit 141 të Statutit, dhe jo për mbledhjet e perbashkëta.

Arsyën e parë mund t'a pranoj portë dytën jo.

Në pranofshin të gjith Z. Senatorit se kjo mbledhje asht vazhdimi i mbledhjes të Korikut e pranoj dhe mund të hyejm në bisidim.

Këndohet shkresa e Kryesis se Asambles Legjilative Nr. 4 me 15-X-1925 drejtu Kryesis Këshillit Ministruer mbi aprovin e marrëveshtjes se bamun midis Qeveriës s' onë dhe asaj të Jugosllavis si mbas propozimit transakcional të Konferencës Ambasadorjale e cila i përket rektifikimit të Kufivet të veriut në nii pjesë të Velopoles e të jugut drejt Shin-Naumit.

Z. S. VUÇTERNI. Z. Kryetar! si mbas kësaj Shkresë që u këndue tanë une them së mund të hyem në bisidim me qenë se prej asajë kuptohet kuartasi se asht vazhdimi propozimit të parë të Kryetarit të Republikës.

Z. E. FRASHËRI. Zotrinj! Mbi përgjegjen që dha Z. A. Dibra une them se mbledhja e të dy dhomave formon Asamblen, dhe të në Qeverija nuk hyenë, dhe atje nuk mundet t'a pyesim, po edhe të mundim t'a pyesim ajo pyetje nuk ka fuqi Legjizative. Prandaj Qeverija duhet të vij këtu e të thotë se Qeverija e sotshme e pranon, se përndryshe të japë dorëheqjen.

Z. A. DIBRA. Z. Kryetarë! Kurse Senati dhe Dhoma e Depytetve ka të drejtë të thres Qeverinë, pse ketë të drejtë mos t'a ket Asamblea. Pra unë them kur të mblidhjemi atje, mund t'a pyesim e në mos e pranoftë t'apin dorëheqjen.

Z. E. FRASHERI. Une Kerkoi gjithnjë që të t'pyetet Qeverija e sotshme, se Qeverija në kte don me na shkue ujin nen rogos, pra duhet të vij këtu e të na thotë se e pranon a po jo?

Z. H. XHEMALI. Ashtu thom edhe unë që duhet të vij Qeverija këtu e t'a baj mallë se edhe neve e kemi këtë të drejtë me thirë Qeverin sikurse e thiri dhe Dhoma e Deputetve.

Z. KRYETARI. Pretendimet janë të drejta dhe mund të thresim Qeverin që t'na japë shpjegime.

Pranohet që të thritet Qeverija.

Z. KRYETARI. 5 Minuta pushim derisa të vij Qeverija.

Mas 5 Minuta pushimi mbledhja hapet.

Z. E. FRASHËRI. Z. Kryetar! Në shkresën që na dërgon Qeverija na flet mbi marrëveshtje që ka bërë Qeverija dorëheqse, por nuk na thot se Qeverija

## MBLEDHJA E XXXIII

e sotshme a e ka pranue kët marrëveshje a po jo?

Z. M. TUTULANI. (Ministr. Drejtësis). Mbasi kjo nuk asht nji vepër e Qeveris sotshme, por e Qeverisë këlume e cila e ka pas pranue, për këto arsyen nuk asht në Kompetencë të Qeveris sotshme për pranim a mos pranim, por asht në Kompetencën e Asamblesë Legjislative, dhe unë si mis i Asamblesë Legjislative do të ç'faqë mendimin t' onë atje dhe do të shifni që do të jemi antari i pranimit.

Z. E. FRASHËRI. Zotrinj! Neve Qeverin e parë që ka dhanë dorëheqjen nuk e njofim, njofim këtë Qeverië dhe duam me dijtë se a e pranon kjo a jo?

Z. M. TUTULANI. (Ministr. Drejtësis). Në kët çështje asht marrë vesht Qeverija domicjonare me Jugosllavinë. Push-teti Eksekutiv gjindet në këtë i angazhuar pa kurfarë Kompetence; çështja e pranimit ose mos pranimit mvaret nga Dhomat Legjislative.

Z. E. FRASHËRI. Qeverija duhet t'a thot çiltasi se a e pranon a jo?

Z. M. TUTULANI. (Ministr. Drejtësis). Qi të mundet Qeverija të thotë se e pranon duhet të jetë në nji pozitë, që t'u thotë dhe se nuk e pranon, gjë të cilën mbasi nuk e ka, se pushteti Eksekutiv ndodhet i angazhuar prej Qeveris së parë. Prandej çështja mbetet në Kompetencën e Z. s' Juaj.

Z. H. XHEMALI. Ministër Z. Tutulan ka dy sifate, si Ministrë dhe si Deputet, si mis i Kuvendit thot se kam me e votue, por pyes Z. e tij se me

cilësinë si Ministrë që gjëndet në Dhomën e Senatit a e pranon a jo?

Z. M. JUKA. (Ministr. P. Botore e zav. Ministr. P. Mbrendshme). Zotni! Neve duke pranuar Delegati i jonë që asht përfaqësuesi Qeveris, e kemi pranuar dhe neve; tash do të flas dy fjalë jo si Ministër por si Prefekt që kam qënë në Shkodër. Kur kam qënë në Shkodër si Prefekt, edhe prej Nënprefektit të Malcis së madhe kam marrë shkresa Zyrtare edhe verbalisht prej Krenve të Malcis e më kan thanë se kjo çështje po rjedh tash tri vjet e kemi kujtue se po damtohem këq. Kjo marrëveshtje si thaç nuk asht për dam t' on, edhe kujtoj si mbas shpjegimeve që dha Delegati i jonë, se edhe në auën të Shen Naumit nuk ka ndoj ndryshim.

Pra unë bahem Avokati i tyre dhe them se ato vende për këtë marrëveshtje janë mirënjoftës Qeveris.

Qeverija këtë marrëveshtje plotësishë e ka pranue se e shef të dobishme e nuk ka ndonji send që asht për dam t' onë, e prandej ju lutem Z. s' Juej që të epni vendimin t' uej e të marri fund çashtja.

Këndohet shkresa e Dhomës së Depytetve Nr. 222 data 14-X-1925 mbi nevojën e mbledhjes të dy Dhomave për me bisedue për çështjen e shkëmbimit të Shen-Naumit dhe nji Raktifikimit të vogël në perendimin të Veljopolës.

(Pason në numrin 24)

# Bisedimet e Senatit

---

(Vazhdon nga Nr. 23, mbledhje XXXIII.)

Z. E. FRASHËRI. Si kuptohet nga kjo shkresë Dhoma e Deputetve ka dhanë nji vendim për shkëmbim gjë të cilën nuk e ka në Kompetencë, se Qeverija asht autorizue vetëm për me bani marrëveshtje, e në qoftë se Dhoma e Depytetve ka dhan nji vendim të till, them se nuk asht nevoj fare për Dhomën e Senatit.

Z. H. XHEMALI. Z. Kryetar! Shkresa e drejtue me prej Dhomës së Deputetve thot për nevojën e shkëmbimit, dhe jo si thotë Z. E. Frashëri drejtë për drejt shkëmbim.

Z. E. FRASHËRI. Nuk mundet të thot nevojën e shkëmbimit, por duhet të thotë nevojën e mbledhjes së përbashkët.

Z. A. DIBRA. Z. Kryetar! Nevoja asht për shkëmbim, e prandej këjo asht e drejtë.

Z. H. XHEMALI. Jo Zotëni, nuk ka të drejtë të thotë nevoja e shkëmbimit se kjo vendoset në mbledhjen e përbashkët.

bashkët, si gabim mund t'a pranoj por pa gabim nuk asht e drejtë.

Z. S. VUÇITERNI. Z. Kryetarë! Me të vërtet shkresa e drejtueme asht jashtë rregullit, se Dhoma e Deputetve nuk ka të drejtë të marrë kësi vendimi, pra neve këte mund t'a konsiderojmë si gabim, dhe kështu të marrim vendim për mbledhjen e përbashkët.

Z. H. XHEMALI. Neve kurse na vjen nji Akt i till nuk mundet t'a pranojm, mbasi asht gabim.

Z. S. VUÇITERNI. Zotrinj! Mbledhja nuk asht bërë mbi aktin e Dhomës së Deputetve po mbi shkresën që na bëri Qeverija. Sa për ate ku thotë se asht bërë gabim Dhoma e Deputetve t'a Korrizhojn gabimin e vet, dhe neve në bazë të shkresës së Qeveris, të marrim vendim për mbledhjen e përbashkët.

Z. H. XHEMALI. Atëher kur të jet kështu, duhet t'i shkruejmë neve Dhomës së Deputetve për mbledhjen e përbashkët.

Pranohet.

## MBLEDHJA E XXXIII

Z. M. TUTULANI. (Min. Drejtësis.) jemi tue mbarue sa nuk mund të bëhet  
Z. Z. Senator, ju lutemi çështja të marri  
fund shpejt se Komisjoni i Kufive âsht  
largue prej Pogradecit dhe ka ardhë  
këtu ku âsht tue prit Desizjonin e çë-  
shtjes.

Z. E. FRASHËRI. Zotëni! Kaq shpejtë

mâ tepër, se tani ka pak kohë që na  
kan lajmëruet, dhe jemi mbledhun për  
me i dhan fund sa mâ shpejt çështjes.

Z. M. TUTULANI. (Min. Drejtësis.)  
U falemi nderit shumë.

Mbledhja mbyllt në orën 6 m. d.

SEKRETARI

KRYETARI

*Spiro Papa*

*Pandeli Evangeli*



## *S H Ë N I M*

*Mbëledhja 34 âsht mbledhje e përbashket  
(Senat dhe Dhoma e Depytetve) dhe është shtypur  
në broshurë të posaçme „Bisedimet e Asambles  
Legjislative.,,*

# BISEDIMET

E

## Dhomës së Deputetvet

### LEGJISLATUR' E I

#### Viti i I. Sesjoni i I.

### MIBLEDHJA E 48

E Merkure me 14 Tetuer 1925, ora 3.30 mëbas dreke

(Kryeson Z. Kostaq Kotta)

Këndohen emnat e Z. Deputetve  
é mungojnë Z. Z. A. Hastopalli, C.  
Kryezi, H. Muftiu (leje) H. Biçaku  
(leje) H. Toska J. Koçi, K. Mjeda  
(leje) K. Kosturi (lejë) L. Llogori, M.  
Libohova, Q. Dëshnica, R. Fico, S.  
Popa (lejë) Dr. S. Pojani, Sh. Alltuni  
(lejë) V. Sevrani, Xh. Zogu (lejë).

Z. KRYETARI: Shumica asht Mble-  
dhja hapet.

Këndohet shkresa e Këshillit Mi-

ntruer mbi çashtjen e kufirit si pason:

*Kryesisë së Dhomës së Deputetvet.*

Në bazën e vendimit Nr. 509 më  
12. X. 1925 të këshillit Ministruer,  
këtu ngjitun kam nderin me j' u pa-  
raqit shkresën Nr. 2944 të Ministriës  
së P. të Jashtme mbi shkëmbimin e  
monastirit të Shën Naumit dhe mbi  
nji ratifikim të vogël në Perëndim të  
Vellopojës, të përojt të Vuçpotok, me  
lutje që të kini mirësinë me e pàra-

## BISEDIMET E DHOMES SE DEPUTETVET

shtrue në studim e bisedim të Dhomavet legjislative tue njoftue përfundimin për veprim.

Tiranë më, 14-X-925

Ministri i Drejtësis  
M. TUTULANI d. v.

Këndohet shkresa e Ministriës së Punve të Jashtme si pason:

Tiranë më 12-X-925

Qeverija e dorëhequr më 18 korrik mas vendimit të këshillit kombtar i përbamun prej të dy Dhomavet, morri autorizimin për një marrëveshje midis Republikës Shqiptare dhe të Jugosllavis për çka i përket çkëmbimit të monastirit të Shën Naumit dhe të një retifikimit të vogël në Perëndim të Velopojës, të projt Voçpotok.

Qeverija e kaluem, në bazë të këtij autorizimit, emnoj delegat fuqipolltë Z. Mehdi Frashërin, i cili nën drejtimin e konferancës e me ndërmjetësimin e komisjonit të kufive erdhë në bisedim (pour parlers) me delegatin e autorizuem Jugosllav.

Delegati jonë, në konformitet me instrukjonet e marruna Qeverisë demisionare, bani bisedimet e duhura e kërkoj zgjanimin e zonës së Peshkopiës dyke përfshië gjith naltësinat stratigjike mbreñda në kufirin Shqiptar e duk e lënë vetëm binan e Shën Naumit mbreñda në Jugosllavi.

Në anën e Velopojës kërkoi gjith karizm e Shkrabotushës me gjith karakollin e vjetër të Turqisë qindodhet në majë, ashtu dhe kullotën e Libohoviçës me gjith rrugën që vete në Lumbraya.

Delegati jon, dyk e dit nevojën e

malsis së jon, kërkoi Majan' e vogël me gjith dy liqene edhe një rrugë që vete në Lumbraya nga ana e lërëndimit, si edhe kutundin Skenjë.

Jugosllavët veç zonës Peshkopiës dha të nji pjesës të Libohoviçës nuk jepnin gjësidi tjetër.

Komisioni i Kufivet i bani uji raport Konferancës duk e thënë se të dy delegatët të interesuën nuk erdhën në nji akord të plotë midis tyne dha kërkoj instruksjone.

Mbi këtë raport Konferanca hoqi nji vijë transaksionale duk e i lanë Shqipërisë anën e Vermoshit kullo-tën e Libohoviçës, dy shtëpi të katundit Grencar, udhen e Lumbrajës, Majan' e vogël me gjith liqenet, kurrizin e Vellopojës me gjith karakollin e vjetër të Turqisë, kodrat e Shën Naumit Nr. 961-965-807-862 me gjith karakollin e Serbiës dhe kishën e Ajazmes.

Sa për katundin Skenjë, me qenë se kufizimi u ba në vitin 1922 ndryshimi në këtë zonë nuk u pranue, edhe këtë vendim j'u a banë të ditun të dy Qeverivat të interesuém tue kërkue nji përgjegje mbreñda 15 ditve.

Qeverija e kalueme pranoj linjën transaksionale me konditë që të aprovohet prej Parlamentit.

Prandaj j'u lueshi të parashtroni çashtjen për aprovimin e duhun me shpejtësi në dy Dhomat legjislative.

Zv. M. i P. Jashtme  
Ministri i P. Mbrëndëshme  
MUSA JUKA (d. v.)

## BISEDIMET E DHOMËS SË DEPUTETVET

Z. KASSO: Z. Kryetar! Prej shkres q' u këndue na u dha të ku tojmë se marrëveshtja nuk qënka bërë midis Qeveriës dhe Jugoslavis si mas autorizimit q' i kish dhënë Qeveriës t'one Asambleja legjislative në Mbledhjen të 17 e 18 Korrikut, por këtu përmëndet Këshilla e Ambasatorvet e Komisjon' i kufivet, prandaj ma parë duhet të na japë shpiegime Z Delegat se si asht kjo çashtje se si dihet të tjera kosekuanca ka marrëveshtja e bamun midis Qeveriës Shqiptare dhe Jugoslavis dhe tjatér asht vendimi i dhanun nga Këshilla e Ambasatorvet.

Z. MEHDI FRASHËRI: Zotni! Si kur se merret vesh edhe prej letrës q' u këndue para Zotnis së Juej arsyja për të cilën Qeverija u detyruanë të hynte në një marrëveshtje me Qeveriën Jugosllave, nuk që se e dëshëronte Qeverija jonë, por kjo u bëmas dy porosinave qì kish ba Këshilla e Ambasatorvet dy Qeveriëvet t' interesueme, ku u këshillonte një marrëveshtje miqsore midis tyne përq' ka i përket konfliktit të Vermoshit e të Shën Naumit. Tash q'do me thënë rekomandim i përsëritun i konferencës Ambasatorjale?

Pik se pari konferenca kufinin e Shënt Naumit tue pa me një pikpamje objektive nuk e quante si një çashtje gjallnore për Shqiprin. E dyta për me marrë masa të repta kundra Jugosllaviës, nuk e shihte në shkallën e rëndësiës për me zgjeth këtë menyrë. E treta se Jugoslavia, ka aleatët e sajë midis Shtetevet të mëdhenj,

sidomos dy prej këtyne nuk ishin të mendimit qysh në fillim qì Shën Naumi t'i jepet Shqipnis. Prandaj ish e parapame se këto të dy Qeveriët e mëdha nuk do të afroheshin për të marrë masa të repta. Më anë tjetër edhe vendimi i gjykatores L' Hajës nuk mund qì të shkelej. Të peshue kjo arsyna konferenca e Ambasatorvet e pa të nevojshëm qì të rekomanajoë dy herë një marrëveshtje miqësore mbi bazën e shkëmbimit. Shiteti Shqiptar i vogël i krijuem dhe i garantuam prej Shtetevet të mëdhenj nuk mund qì të mos merte përasyshtë porosinë e Pushtetevet Mëdha. Kjo që shkaku që e shtyti Qeveriën për të ba një marrëveshtje me qeveriën Jugosllave tue marrun para syshtë interesat e të mirët e Shtetit. Drejt përdrejt me Jugosllavinë në këtë pikë nuk kishim të banim, se kufinin e caktuam prej Shtetevet Mëdhenje kishim pranue edhe lypnim zbatimin e sajë. Por mas dy rekondimevet të konferencës Ambasatorjale e pa të dobi shme të hynjë në një marrëveshtje, edhe kështu para se të bënte hapat e duhuna kërkoj një autorizim prej Asambleës legjislative.

Mbas shumë bisedavet autorizimi i duhun ju dha edhe Qeverija demisionare tue pa se una prej dy vjet e gjyms kam qënë në këtë çashtje mbrënda, në bazë e autorizimit qì morri prej Z. Juej me emnoj si Delegat fuqipotë për me bisedue çashtjen me delegatin e autorizuam të Qeveriës Jugosllave, por nënë drejtimin e Konfr.

## BISEDMET DHOMËS SË DEPUTETVET

Ambasatorjale edhe me ndërmjetsinë e komisionit të kufivet. Kur u nisëm na për në Paris shtypi Jon edhe më duket mbas lajmërimit të Zyrtës së Shtypit botoj se Mehdi Frashëri vajti në Belgrad për me ba marrëveshtje me Jugosllavinë!

Jo, Zotninj, kjo nuk asht e vërtetë, se na nuk kishim punë në Belgrad, se misjoni ynë që për në Paris ku ndodhet komisioni i kufivet, i thirun prej konferencës Ambasatorjale bashkë me delegatin Jugosllav.

Kur do të shkonje për Paris, kërkova instruksjone prej Qeveriës. Ajo m' u përgjigj se ti çashtjen e di mirë edhe përpiku që të marrëm sa më shumë.

Me gjith këtë në vijen e pergjithshme Qeverija më caktoj disa pika.

Mbasi vajtmë në Paris, komisioni i kufivet na porositi të dy palëvet që të bisedojmë veçanërisht edhe kur në jemi në konflikt, t'u drejtohem i atyne. At' herë unë u përgjigja se: reve pranojmë kufin e caktueme, delegati Jugosllav, në ka nonji gjësendi, mund të proponojë edhe për mbi atë të bisedojmë.

At'herë delegati Jugosllav deklakroj se nga Vermoshi heqin dorë edhe i'a lëmë Shqipnjs, vetëm kërkojmë përuan e Voçipotokut që ndodhet në perëndim të Velopojës edhe Shën Naumin. Për këto të dy pika, Qeverija Jugosllave, i jep Shqipnis katundin Peshkopi me anë e sipërmë të valesë-Çarvës, edhe një pjesë të kullotës q'i thonë Libovicë në zonën e Gusinjës e ngji-

tun me Vermosh. Në kërkue më zgjanimin e zonës të Peshkopis dyk e përfshi në kufinin shqiptar gjith naltësinat strategjike që zotnojnë fushën e Shën Naumit e që marrën në vërejtje fushën e Starovës edhe më anën tjetër gjith naltësinat që menasojnë udhën e Korçës në zonën e Çeravës. Me këtë vijë i lini më vetëm binanë e Shën Naumit me detajet e saj.

N'anën e Vellopojës, kërkuan kurrizin që zo'non valen e Shkrapatushës me gjith karakollin e vjetër të Turqis që ndodhet në majë si dhe kullotën e Libovicës me gjith rrugën që vye në Lumbrajë, katundin Skenjë në breg të liqenit Shkodrës edhe për me lehtësue nevojat e Kelmenit kërkova dhe Majanit e vogël me gjith dy liqenet edhe me një rrugë që vete në Lumbrajë nga an'e perëndimit. Masi ramë në pazarllék delegati Jugosllav na u përgjegj, se veç katundit Peshkopi dhe zonës së sajë ashtu dhe një pjesë të Libovicës nuk jepte gjësendi tjetër. Unë u përgjigja se nuk jam i autorizuem prej Qeveriës për me bësimeve komisioni i kufivet, bëri një raport konferancës Ambasatorjale, ku i thoshte se të dy delegatët t'interesuam, me gjith që janë afrue, por nuk kanë mbetur dakord plotësisht edhe kërkonte instruksjone të veçanta.

Në bazë të këtij rapporti të ngjitur me kroqitë vëndevedet, hoqi një vijë mesatare, me të cilën na jepte nga an'e Vermoshit, kullotën e Libovicës, dy shtëpi të katundit Grençar,

## BISEDIMET E DHOMËS SË DEPUTETVET

udhën e Lumbrajës, Majan' e vogël me gjith liqenet, kurrizin e Velopojës me karakollin e vjetër të Turqis siç e kishim kerkue. Nga an'e Shën Na umit, naltësinat 916-965-807-862 me gjith karakollin e Serbisë qì ndodhet pranë Shën Naumit dhe kishën e Ajazmës. Sa për katundin Skenjë, konferanca nuk pranoj të bahet ndryshim se ky vend ish kufizue me 1922. Konferanca e Ambasatorvet këtë vendim j'u a bëri të njohtun të dy qeveri-vet t' interesueme me nji afat të caktuem.

Të dy Qeveri-vet e pranuen, por Qeveria Shqiptare, bani nji rezervë, qì kjo marrëveshtje mund të jetë në fuqi, mbasi të marrë aprovimin e Asamblesë Legjislativë si mas fjalës q' u kish dhanë para dy Dhomavet kur morri autorizim për marrëveshjen.

Tash do të them pak fjalë para Z. së Juej qì të dëgjojë Shtypi, edhe gjith populli, se në këtë çashtje o pa dashtun ose nga pa dija po bahan krime morale qì ngatrojnë popullin. Midis Shqiptarvet thuhet se Shën Naumi dhe Vermoshi j'u shit Serbisë ! Këto lajme janë kaq përhapun, sa dhe legasjonet e huej t' akreditue-me pranë Qeveri-vës i kanë besue kaqë, sa tue u fjalos me Kryetarin e komisjonit Gjeneral Gazera-n, i thanë se j'u dha Shën Naumi dhe vermoshi Jugoslaviës. Gjenerali me habiti të madhe përgjegji dhe u tha se: "unë jam Kryetari i komisjonit, por nuk ë di të jetë dhënë Vermoshi,,. Ky vënd krejt i mbetet Shqipnis. Shën Naumi,

për të cilën bahet potere e madhe asht vetum tre qillometra dhe çkëmbehet me nji zonë miaft të madhe dhe të dobishme për Shqiprinë. Pra po j'u them Zotninj se Vermosni me gjith kufit e vet i mbetet Shqipnis, asht i joni dhe e kemi në dorë, veçm në Perëndimin e Velopojës, përroj qì quhet Voçipotok i lirez Jugoslavisë dhe për kundra kësaj marrëm bjeshkën e Libovicës, dy shtëpi të Grençarit, udhën e Lumbrajës, Majasin e vogël me gjith dy liqener. Në Shën Naum japim vëlum godinat e Shën Naumit me tri qillometra vënd edhe marrëm katundin Peshkopi, tri të katërtë e valës së Çeravës me nji gjansi 21 qillometra katrore. Në këto 21 qillometra qì marrëm, kanë ara, kulla edhe pyje, katundet Tushemisht, Zegoriçan, Çerava, edhe Halarup. Kur jeshe këtë rend në Pogradec, m'u mbluadhën disa katundarë prej banorëvet të këtyne katër katundevet qì janë drejt për së drejti t' interesuem në ketë çkëmbim dhe më thanë qì: Mos dëgjoni fjalët qì thuhen posht e lartë se ky shkëmbim asht i nevojshmë për na.

Tash lipset të japim përgjigje nji fjalës qì thuhet tutje e tu. Kur qënka kshtu, qì shkëmbimi na intereson neve, për se e do Jugoslavija ?

Kjo asht nji pyetje e logjiksheme dhe e arsyeshme qì duhet t'i japim përgjigje. Po të botohen gjith dokumentat mbi çashtjen e Vermoshit e të Shën Naumit, merret vesh se Jugoslavija kërkonte gjith Vermoshin tue

## BISEDIMET E DHOMËS SË DEPUTETVET

pretendue se kjo zon e madhe formon rji bryll që hyn midis Gusinjës, Andrévicoës edhe Podgoricës, ndalon komunikimin midis këtyne vëndevet edhe krijimin e një vijës të hekurt midis Serbisë dhe Adriatikut, pra insistonin që ta mbanin. Në vitin 1923 në ato kohra kur u vra Zheneral Tellini duallën Bajrakët e Kuçit dhe të Vasoviqit edhe ndaluen komisarin Francës që kishtë shkue me caktua kufirin Mbi këtë ngjarje konfer. e Ambasadorvet dha urdhër që të ndalohet caktimi deri sa të bahet një anjet mbi zonën e Vermoshit.

Më 1924 vamë bashkë me komisionin e kufivet në Podgoricë, Andrijevicë dhe Kusinë. Komisioni bani hetimet e vëta edhe në me një raport të dokumentuem, i parashtruem komisionit gjith arsyet me të cilat provoj se Vërmoshi lipsej t'i mbetej Shqipnis. Delegati Jugoslov pos disa arsynevet të tjera bazojët mbi nevojën ekonomike për me cil një udhë të hekurt dyk e kalue prej valesë Vermoshit. Këtë ja refuzuan dyk e thënë se malet e Karadagut nuk janë për shemindefere normale. Vija naturale për një udhë të hekurt Danub-Adriatik ashtë bëgu i Drinit. Si ç' quajnë të gjith Shtetet që janë kufitar, si cilë do ban pjesën e vet në tokën e vet edhe lidhin marrëdhënje ekonomike. Mbi këto ngarje, komisioni dha vendim që Vermoshi duhet t'i mbejet Shqipnis. Dimrin që shkoj komisioni i kufivet, u thir në Paris postafat përkëtë çashqje. Bashkë me komisjonin

shkuam edhe neve. Fundja Konfer. e Ambasadorvet mbas shum konfliktevet aprovoj mendimin e komisjonit. Ma në fund Jugoslavia hoqi dore prej Vermoshit dhe për me kënaq Bajrakun e Kuçit, kërkoi vetëm përruan e Voçipotokut se ish pasuni e tyne dhe në kohen e Turqis i ka pas takue bajrakut Kuçit.

Shen Naumin e kërkonte pa shpërbirim se e konsideronte një çashqje fetare dhe Slave. Mbi këto konflikte që s'gjenin fund Konfer. e Ambasatorvet na rekomandoj dy herë marrëveshje miqsore. Pra marrëveshja nuk u ba për hatërin e Serbise dhe mbas dëshirës së tyne, por u ba mbas pik-pamjes konferencës Ambasatorjale, e cila nuk deshëronte edhe damin e Shqipnis

Prandaj j'u a përsoris edhe një herë se Vermoshi me gjith një zonë të madhe asht i joni edhe nuk asht dhënë si flitet tutje e tu.

Z. V. BAMIHA: Këtë e shkruanin edhe fletoret e huaja.

Z. M. FRASHËRI: Kur isha në Itali e në Podgoricë, Shqiptarët që ndodhen atje më thanë dhe mue që: Ju ja dhatë Vermoshin Jugoslavës. Edhe unë j'u përgjegjja: Kur të faleni e të vini në Shqipni, Shkoni në Vermosh, Hani një mish të pjekun, pini një uje të ftotë, dhe at' herë binduni se Vermoshi nuk i asht dhënë Jugoslavës. Kufini i sodshëm i Shqipnis nga qendr' e Vermoshit asht një dit larg me kalo.

Z. K. FLOQI: Do t' j'u pyes Z.

## BISEDIMET E DHOMËS SË DEPUTETVET

Delegat se si u përfundue kufija nga an'e Shën Naumit, a u largue kufija prej rrugës që shkon në Korçë?

Z. M. FRASHËRI: Në zonën e Shën Naumit na u dhanë gjith kodrat që ndodhen në rreth me gjith karkolllet e Serbisë. Xhadeja e Korçës mbas kufinit të sodshem mbetet shumë larg, me tahmin 10 është 12 qillometra. Po të dëshëroni, shikoni hartën që kampërpëra edhe vijën e kufinit

Z. XH. YPI: Si mbas proponimit të Qeveriës më 17 të muejit Korrik, u mblohdën të dy Dhomat së bashku dhe si dëgjuan ekspozën që bëri Qeverija i dhanë autorizim Qeveriës të hynte në një marrëveshtje me Qeveriën Jugosllave për të bamun një ndrim në kufit si mbas rekomandimit të Konferencës Ambasatorvet dhe si të bëhet marrëveshtja kjo do të paraqitet përpëra të dy Dhomavet për aprovim ose refuzim. Pra Qeverija, si ç' do përfundim q' i ka dhënë kësaj çashije, duhet t' a parashtronjë përpëra të dy Dhomavet për aprovim, kështu që bisetën që po bajmë tash unë e shoh të pa-kohëshëm, dhe përkëtë proponoj të merret një vendim për t'u mbledhun të dy Dhomat së bashku.

Z. M. KASSO: Ma parë duhet të dimë se marrëveshtja që asht bërë me ç' far qualitet ashtë bërë.

ZANA: Kundërshtimi.

Z. M. KASSO: Zotrinj! Po nuk kuptova se Këshilla e Ambasatorvet ka dhënë ose jo vendim për kufit tonë, nuk mundem të votoj për të

bamun një Mbledhje të përbashkët. Në qoft se konferanca ka vendosur çaktimin e kufisë, mua më duket se neve nuk kemi konpetencë t'a pranojmë vendimin e Konferancës së Ambasatorvet se kjo asht e drejtë e Qeveriës, se si thashë kjo asht jashtë detyrës tone.

Z. M. FRASHËRI: Këtu Këshilla e Ambasatorvet ka bërë një detyrë ndërmjetse d. m. th. nuk ka dhënë një vendim obligatorio, por vetëm na rekomanodon të bahet një marrëveshtje me këtë mënyrë, me qëllim që është mos këtë ngrindje midis dy shteteve në Ballkan.

Z. XH. DINO: Disa muej ma parë kishim autorizuar Qeveriën të bënte një marrëveshtje me Qeveriën Jugosllave, për dy pikat që kishin ngelur të hapuna në kufirin t' onë. Pra në këto të dy muej që kemi qënë na në vakkancë çashija ka rjedhun ashtu si e shpiegoj Z. Delegat, kështu që propozimi që bëri Z. Xh. Ypi asht i drejtë, se neve nuk mundemi të bisedojmë vetëm mbi këtë çashje, por duhet të marrëm një vendim për mbledhje të përbashkët.

Përkrahët

Z. KRYETARI: At'herë po e vë në votë; Kush asht antar për t'u marrun një vendim për t'u bërë mbledhja përbashkët për çashjen që kemi në bisëdim, të ngrerë dorën.

Pranohet unan'misht.

Z. KRYETARI: At'herë bajmë 5 minuta pushim deri sa t' ja njoftojmë këtë vendim Senatit.

## BISEDIMET E DHOMËS SË DEPUTETVET

(Bahan pesë minuta pushim dhe mbas pesë minutash Mbledhja mbshtillet prap)

Z. KRYETARI: Na ka ardh përgjigja nga Senati të cilën po j' u këndojmë Z. së juej.

Këndohet shkresa e Senatit Nr. 88-III d. 14;X-925 si pason:

Së ndershmes Kryesi së Dhomës së Deputetvet.

Në përgjegje të shkresës s' uej Nr. 222, d. 14-X-925, kam nderin me i bam të njoftun asaj P. T. Kryesije, se Senati në mbledhjen e vet më 14-X-24, tue patun në bisedim çashtjen

Sekretari  
**Ferid Vokopola**

e shkëmbimit të Monastirit të Shën Naumit dhe me një radifikim të vogël në Përëndim të Vellopojës, të prrojt Voçpolok, paraqitun prej Qeveriës si mbas vendimit të marrun prej Asambles me datë 18 Korrik 1925, vendosi me vota të përbashkta nevojën e mbledhjes së përbashkët të dy Dhomavet si mbas nenit 141 të Statutit.

Me nderime të posaçme  
Kryetari i Senatit  
**Pandeli Evangjeli (d. v.)**

Pranohet  
Mbylljet seanca ora 4.30 m. dreke.

Kryetari  
**Kostaq Kotta**

## MIBLEDHJA 49 ASEMBLE

E Merkure me 14 Tetuer 1925 ora 5.30 mbas dreke

(Kryeson Z. Pandeli Evangjeli)

Këndohen emnat e ZZ. Senatorët e mungojnë ZZ: Eqrem Vlora, Ibrahim Xhindi, Nafiz Dervish, Pjetër Shan Deda (me leje) Sami Virioni, Spiro Papa, Shefqet Verlaci, Shuk Seriqi (me leje).

Këndohen emnat e ZZ. Deputetve e mungojnë ZZ: Ahmet Hastopalli, Ceno Kryeziu, Hamid Muftiu (me leje), Hasan Biçaku (me leje), Hysni Toska, Jak Koçi, Kolë Mjeda (me leje), Lon Llogori, Mëfid Libohova, Rauf Fico, Simon Popa, Dr. S. Pojani, Shasavar Alltuni, Veis Sevrani, Xhelal Zogu (me leje). Kolç Deda (mungon).

Z. KRYETARI: Shumica asht e mbledhja hapet. Bisëdim mbi ratifikimin e kufinit n'anë të Sh. Naumit e në Prendim të Veljopoles e të projit Voçpotok me Jugosllavin.

Këndohet shkresa e Këshillit Ministrjal N. 1272]II datë 14-X-925 si pason :

*Kryesis së Dhomës së Deputetve*

Në bazen e vendimit N. 509 me 12-X-925 të Këshillit Ministruer, këtu ngjitun, kam nderin me ju paraqit shkresen N. 2944 me 12-X-925 të Ministris së P. të Jashtme mbi shkembimin e Monastirit të Shen Naumit

dhe mbi nji ratifikim të vogel në Prendim të Veljopjes, të projit Voçpotok) me lutje që të keni mirësin me e parashtrue në studim e bisëdim t Dhomave Legjislative tue na njoftue profundimin për veprim

Ministri i Drejtësis:  
M. TUTULANI m. p.

Këndohet shkresa e Ministris së P. të Jashtme N. 2944 datë 12-X-25 si pason:

Qeverija e dorhequr me 18 Korrik, mbas vendimit të Këshillit komtar i përbamun prej dy Dhomaver, morri autorizimin për nji marrëveshtje midis Republikës Shqiptare dhe të Jugosllavis për ç' ka i përket shkembimit të Monastirit të Shen Naumit, dhe të nji rektifikimit të Vogel në perrendim të Veljopjes, të projit Voçpotok.

Qeverija e kalueme, në bazë të ketij autorizimi, emnoj Delegat fuqi ploë Z. Mehdi Frasherin, i cili nen drejtimin e konferencës e më ndermjetësin e komisionit të kufivet erdhë në bisëdim (pour-parlérs) me Delegatin e autorizuam Jugosllav.

Delegati i jonë, në konformitet me

## BISEDIMET E DHOMËS SË DEPUTETVFT

instrucionet e marruna prej Qeveris dimisionare, bani bisedimet e duhuna dhe kërkoi zgjanimin e zonës së Peshkopis duke përshtë të gjithë naltësinat strategjike mbrenda kufinit Shqiptar e tuke lanun vetem binan të Shen Naumit në Jugosllaví.

N'anën e Velopoj-s kërkoi gjithë kurrizin e Shkrabotushës me gjithë Karrakollin e vjet-r të Turqis që ndodhet në maje, ashtu edhe kullotën e Libovicës me gjithë rrugën që vete në Lumbraya.

Delegati i jonë, duke e ditë naven e Malcis s' onë, kërkoi Majan e vogel me gjithë dy liqenë edhe një rrugë që vete në Lumbraya nga ana e përëndimit, si edhe kaundin Skenje.

Jugosllavet veç zonës së Peshkopis edhe një piesës së Libovicës nuk jepnin gja sendi tjeter.

Komisjoni i kufivet i bani një raport konferencës duke thanë se të dy Delegatët t'interesuem nuk erdhne në një akord të plotë midis tyre dhe kërkoi instrukcionë,

Mbi këtë raport Konferanca hoqi një vij transaksjonale, duke i lancë Shqipnis n'anë të Vermoshit kullotën e Libovicës, dy shpëtë katundit Grençar, udhen e Lumbrajes, Majan e vogel me gjithë Liqenat, kurrizin e Veopojes me gjithë Karrakollin e vjet-r të Tyrqis, kodrat e Shen Naumit 4, 961, 965, 807, 862, me gjithë karrakollin e Serbis dhe Kishen e Ajazanes;

Sa përkatundin e Skenjes, me qenë se kufizimi u ba në vitin 1922, ndry-

shimi në ketë zonë nuk u pranue, dhe ketë vendim ja u banë të ditur të dy Qeverinave t'interesueme duke kërkue një përgjegje mbrenda 15 ditëve,

Qeverija e kalueme e pranoj linjen transakcionale me kondit që t'aprovohet prej Parlamentit.

Prandaj ju lutemi të parashtroni çashtjen për aprovimin e duhur me shpejtësi ndër dy Dhomat Legjislative.

Zav. i Ministris së P. të Jashtme  
Ministri i P. të Mbrendshme

MUSA JUKA m. p.

Z. E. FRASHERI: Z. Kryetar! Mbës shkreses që u këndue këtu, merret vesht çiltazi se ç'ka ka kërkue Qeverija e jonë e çka ka kërkue Qeverija Jugosllave. Atje thotë Qeverija Shqiptare çiltazi, se dy Q verinat nuk mbeten d'akord dhe hyri në mes komisjoni i kufivet, po jo në mes të këtyre Qeverive, po lajmeroj Konferencen e Ambashatoreve. Duket çiltazi se këjo terhurazi prishi vendimin e parë, bani një vi tj. terjasht vendimit të parë, dhe në 15 ditë e sipër këtë përgjegjën nga dy Qeverit në e pranojnë atë vendim që terhurazi kishte dhanë konferanca e Ambashatoreve

Tash neve ndodhemi përparrë një faktit të konferecës s' Ambashatoreve e jo një faktit të (marrëveshje) të dy Qeverive.

Un nga ana e ime e pranoj si vendim që asht dhanë nga konferanca e Ambashatore dhe japë voten për ratifikimin për të gjithë kuf'nin e Shqipnis, Jugosllave e Greqë si pas vendi-

## BISEDIMET E DHOMES SE DEPUTETVET

mit që ka dhanë konferenca e Ambashatoreve.

ZANA: Pranohet . . .

Z. H. KASO: Z. Kryetar! Edhe kur që mbledhun Dhoma e Deputetve kam thanë se gjindemi para një vendimit të konferecës s' Ambashatoreve, të cilin nuk kemi të drejtë mos t'a pranojmë, se asht një vendim i dhanun prej konferencës mbredha në kompetencen që ka posë ajo.

Prandaj jam i mendjes që ketë vendim nuk kemi të drejtë mos t'a pranojmë, dhe nuk ka kompetencë Asembleja të diftoj, në e pranon a po jo, se asht vetveti i pranuem deri sa asht një vendim i konferencës s' Ambashatoreve.

ZANA: Të vihet në votë propozimi i Z. Eshref Frasherit . . .

Z. XH. YPI: Me gjithë që nga shkresa e Qeveris kuptonet ciltazi si ka rrjedhë puna, për të kuptue çështjen ma hollësish, kërkoj që Qeverija o Delegati i sjajë të na napë shpiegime.

ZANA: S'ka nevojë pse u dhanë..

Z. S. BLLOSHMI: Z. Kryetar! Në vjetin 925 dy herë po mblidhen Dhoma e Deputetve dhe e Senatit së bashkut, për çashtjen e ratifikimit të kufinit. Përpara kësajë mbledhje, në mbledhjen e parë të Asembleës neve kemi autorizuar Qeverin të bajë një marrëveshtje për çështjen e kufinit Shqiptar-Jugosllav, doemos tue shikues interesat t'ona.

Pas autorizimit që i dhamë Qeveris shofim, se si mbas shpjegimevet që n'a dha Delegati Shqiptar pranë ko-

misionit të kufivet, se mbi ato pika, po thuej, që at-herë e kishim autorizuar, bani një marrëveshtje dhe sot e paraqiti këtu e cila në pikëpamje teknike, po thuej, asht ma në favor t'oni. Disa kodra të Shen Naumit me vendim që po merret për së dytit, po mbenët në kufit t'oni.

Nuk do të zgjatemi mbi ketë çështje, me qenë se asht studjue fare mirë vetem do të përmendi një pikë, dhë pikë për Shen Naum ka qenë për nji si të sigurojnë rrugen Pogradec-Korçë me qenë se ky vend menasote (menacer) kumunikacionin të rrugës ndërmjet të Pogradecit e të Korçës. Këj tokë tanë po mbetet në kufi t'oni, dhe me kaqë mund të sigurohet këj rrugë.

Sa për çështjen e Andrijevicës et kufinit të veriut, sa do që kam studjue në kartë, ato vende nuk i njoftoj për s'afemi, po i xa besë fjalve Z. Delegatit, dhe kujtoj se nuk asht aq i tepër në disfavor të t'oni. Mbetet vetëm një çashtje, mbetet një pikëpamje prestigji edhe çashtje esenciale për të cilën muërem vendimin e parë Arsyja-që unë do të kishe pretenduar të mbajmë Sh. Naumin,-qi çashtje e kufinit të marrë fund një orë e ma parë, e të dijmë se ku i kemi kufit. Këjo që pika esenciale dhe arësy janë e madhe që i dhamë voten t'oni atëherë për një marrëveshtje. Pastaj asht për t'u marrë para syshe edhe një pikë tjeter, në pikëpamje propagande. Për ketë ndryshim, ose ratifikim janë thanë gjithfarë fjalësh, di-

## BISEDIMET E DHOMËS SË DEPUTETVET

kush thotë u shit Shqipnija, dikush trahitor e dikush tjeter, d. m. th. në pikëpamje propagande u thanë të gjitha fjalët e këqija. Prandej Qeverija e ka për detyrë të ndriçoi popullin, opinionin publik si dhe të këshillojnë miqët i onë që janë përjashta përendalesen e një propagandës të tillë, dhe t'i jepin të kuptojnë atyne, se neve nuk po bajmë një trahiti, po u shternguem të pranojmë një ndryshim vëtëm nga nevoja. Ketë Qeverija e ka për detyrë me mjetet e sajë të i a baje të dijtun gjithkuj.

Pastaj kërkoi që Qeverija të na sığuroi që në qoftë se votohet ky ratiifikim, a do të marrë fund çashqia e kufinit njihet e për gjithmonë? në qoftë se çashqia e kufinit me ket ratiifikim mbaron, unë e ja voten, po në qoftë se do të mbasin prap hapët, atëherë asht kot që t'i jepim voten.

Z. M. FRASHERI: (Del. i Kom. Kuf.): Çashqje e kufivet do të gjejë fund pa dyshim, dhe me ketë aprovim gjenë fund, edhe çështje kufini shqiptar nuk existon më.

Z. S. VUÇITËRNI: Z. Kryetar! Në mbledhjen e parë u ndodhëm përparraproponimit të Qeveris me të cilin kerkonte me i u dhanë autorizimi me hyё në marreveshje, dhe atëherë vendimi i kësaj Dhome, autorizoj Qeverin të hyën në marreveshje, për ndryshim të kufinit në favor të Shtetit t' onë, dhe në mbledhjen e aferme të paraqesin atë marrëveshje, dhe në qoftë se duket se asht në favor t' onë natyrishët do t' aprovohesh, dhe pë-

kundrazi do të refuzohesh.

Sot që vijmë e bajmë mbledhjen t' onë nuk ndodhemi përparrë marrëveshjes të Qeveris, po përparrë vendimit të Konferencës s' Ambasadorvet.

Më duket, si kuptohet nga aktet zyrtare të Qeveris, se Qeverija e jonë nuk paska ra d' akord me Qeverin Jugosllave, po paska hye në mes Konferenca e Ambasadorvet, e cila ka dhanë vendimin e saj edhe i a paska komunikue dy Shtetevet e kerkon përgjegë mbredha 15 ditve.

Më duket Z. Kryetar se fjalët që po bajmë janë të kota, se nuk ndodhemi përparrë një marreveshje, po përparrë një vendimit të Konferencës s' Ambasadorvet.

Prandej bashkohem me Z. Eshref Frasherin që thotë t'a votojmë vendimin që ka dhanë Konferenca e Ambasadorvet e edhe çështja të marrin fund.

ZANA: Mjafton e të vibet në votë.

Z. NDREK KIÇI: Z. Kryetar! Kah herë po ndijë se po thohet fjalë propaganda, dhe ketë e tha edhe Z. Mehdi Frasher, delegati i Qeveris, dhe me këto fjalë më duket se u vra tepër Shkodra Shkodra nuk asht vendi ku bahan të këtilla propaganda, dhe ato fjalë që janë folë në Shkodër, janë shkaktue nga frika e madhe, se Shkodren e ka kapë halli e ka pasë frigë mos të mbarojnë Vermoshi, se po mbaroi Vërmoshi, mbaron të gjithë Malsija e me të Shkodra. dhe mbas gjithë këtyne hallesh ka pasë edhe të drejtë. Shkodra Zotni, asht ajo që

## BISEDIMET E DHOMES SE DEPUTETVET

asht vra tash 400 vjet me Shkja e me Turk e ka luftue per indipendecen e Shqipnis; Shkodra che populli i saj, asht nji popull i ndershem e patriot qi nuk asht kursye kurrë per komb e Atdhe dhe nuk ban propaganda, po shka do qi te ketë folë e ka ba prej hallit e friget te madhe, se kur ndigjohet se po ndryshohet Statuti, kudo i hyen friga. nuk a ba, po ka mujte me u ba.

Mbassi Vermoshi po na mbetë ne edhe kufini mirë a keq, asht në favor t'onë, e jap edhe unë voten t'eme.

ZANA: Në votë Z. Kryetar.

Z. M. FRASHERI (Del. i Kom. Kuf): Përpara se të vihet në votë lypet të shkoqitet nji gjë, qi vendimi i Konferencës s' Ambasadorvet asht nji vendim haqemi (arbitri) e jo si gjykatore. Ajo Këshilloi të merremi vesht, dhe ajo dirigoi bisedimet midis dy palve dhe tha me qenë se keni ndeshë në pengime po ju hye në mes, dhe hoqi nji vijë tranzacionale. Ky vendim i dytë i Konferencës s' Ambasadorvet nuk asht nji vendim si Gjykatore, po si haqem (arbitrë), dhe ketë i a komunikoi të dy Qeverivet t' interesime dhe kerkoi përgjigje nibrenda 15 ditve, e pranon apo jo. Qeverija e jonë e pranoi, me konditë në qoftë se e pranon Asembleja.

Tashki Zotnija e Juej do t' aproponi nji vendim qi ka dhanë Konferanca e Ambasadorvet si haqem (arbitrë), se Konferanca nuk e ndroi vendimin e parë, po hyri në mes, hoqi

ketë vijë tranzacionale dhe dha nji vendim haqemi.

Ketë vendim e ka pranue edhe Qeverija Jugosllave, tashki Z. e Juej si te doni, veproni.

ZANA: E pranoi edhe Parlamenti Jugosllav?

Z. M. FRASHERI (Del. i Kom. Kuf): Ketë nuk dijë, po Qeverijá Jugosllave e ka pranue.

Z. E FRASHERI: Ai haqim qi më ka gjykue heren e parë, po më gjykon edhe heren e dytë; më ka pre nji kamë e nji dorë, dhe sot po me pret edhe doren tjetër. Ket vendim do t'a pranoi nga zori.

Duertrokitje.

Z. XH. YPI: Të vihet në votë nominale.

ZANA kundershtimi . . . , s' ka nevoje.

Z. F. VOKOPOLA: Z. Kryetar! Ka edhe nji arësyë tjetër qi asht nevojë qi votimi të bahet nominal, se heren e parë ata qi kishin thanë jo sot mund të thonë po, dhe kështu duen të shpjegojnë voten e tyre.

Z. S. BLLOSHMI: Nuk ka nevojë për votim nominal, ai qi nuk e pranon të ngrihet e të thotë jo e të trajtojnë arësyet pse nuk e pranon.

Z. M. BUSHATI: Në mbledhjen e parë vetëm Shkodranët qenë kundra, dhe sot mbas shpjegimeve që dha Qeverija me anen e delegatit të sajë nuk e kanë më atë kundërshtim.

Z. K. FLOQI: Z. Kryetar! Heren e parë kam qenë kundërshtar, sot jam pro.

## BISEDIMET E DHOMËS SË DEPUTEVËR

Z. KRYETARI: Kush asht antar i pranimit të marreveshjes, të ngrehë doren.

Z. E. FRASHERI: Me duket se dy Dhomat pranuene proponimin t' im. Prandej mos të vihet në votë marreveshtja.

Z. M. FRASHERI (Del. i Q. p. K. K.): Nuk mund të thuhet se nuk asht një marrëveshje. Neve treguam faktet që kanë ngjarë në Konferencen e Ambasadorvet, dhe mbassi ndodhi një konflikt, një mos-marrëveshje në mes të dy Qeverivet Konferencia hyni në mes si arbitre, dhe caktoj një vijë transacionale. Ketë marrëveshje nuk tha se jeni të të detyruem t' a pranoni, po me gjithë ate Këshilla Ambasadoriale moralisht ka një prestigjë dhe marreveshja gjithnjë qindron.

Z. XH. YPI: Z. Kryetar! Si pas shpjegimevet të [delegatit t' onë Z. Mehdi Frasherit] merret vesht, se Qeverija e jonë hyni në bisëdim, po nuk u muer vesh, dhe atëherë Konferanca hyri në mes si arbitër, dhe dha ketë vendim në mënyrë arbitri. Ky vendim nuk asht i detyrshëm dhe sot pranimi apo mos pranimi asht në dorë t'Asambleës. Neve nuk pranojmë vendimin e Konferencës s' Ambasadorvet, po vendimin që jemi marrë vesh.

Z. XH. DINO: Këtu konferanca e Ambasadorvet ka dhanë një vendim në mënyrë arbitragji, dhe mbrenda 15 ditvet ka kerkue pranimin ose refuzimin e tij. Unë kujtoi se mund të vihet në votë kështu: "Asemblaja legislative pranon ratifikimin e vendimit në mënyrë arbitri të Konferencës

s' Ambasadorvet.

Z. M. FRASHERI: Qi të jetë Asembleja në konformitet me mënyrë, jam i mendjes të thuhet kështu: Të dy Dhomat të mbledhuna së bashkut aprovojnë vendimin të pranuem nga Qeverija e të propozuem nga Këshilla Ambasadoriale.

Z. J. ERABARA: Qeverija Jugosllave, a është pranue? . .

Z. M. FRASHERI: (D. i Q. p. K. K.) Po.

Z. XH. DINO: Unë proponoi të votohet kështu: Të dy Dhomat e mbledhuna së bashku, ratifikojnë vendimin arbitrash të pranuem nga të dy Qeverit.

Z. E. FRASHERI: Pse losim me fjalë. Këshilla e të madhit asht urdhër dhe K. e Ambasadorvet për mos të rezuar dinjitetin e tij nuk thotë se dhaçë një vendim definitiv, po një vendim arbitri. Për mua asht urdhën, dhe e pranoi si urdhën.

Z. MUSA JUKA (Min. i P. Botore e Zav. M. J.): Zotnija e Juej e dini mirë si ka rjedhë këjo çashqje përpëra, dhe na sado që jemi të rrij në ketë detyrë, kemi mjujtë me e studjue çashqjen e kemi marrë vesht, se Qeverija ka qenë autorizuam me vendimin e të Dy Dhomavet me hye në marreveshje me Qeverin Jugosllave. Qeverija ka qenë autorizuam me vendimin e të Dy Dhomavet me hye në marreveshje me Qeverin Jugosllave. Qeverija tue u mbështetë në ketë vendim të perbashkët hyni në marreveshtje, po në mes të tyne, hyni Kon-

## BISEDIMET E DHOMËS SË DEPUTETVET

ferenca e Ambasadorve, jo si urdh-nues, po si këshillues, e si merret vesht edhe prej fjalvet të Delegatit t' onë Z. Mehdi Frasherit, vepra e K. s' Ambasadorvet ka qenë nji këshillë si me ra në godi. Si tha Delegati i jonë Qeverija jugosllave, ka kerkue shumë, dhe gjithë ashtu edhe Qeverija shqiptare, dhe Konferanca e Ambasadorvet, tue dishrue qì të dy Qeverit të merren vesht ka hyë në mes dhe kanë ra në ketë marrëveshtje. Në ketë marrëveshtje nuk i bje nji dam Shtetit përkundrazi Shteti ka nji dobi. Do të Ju tham Z. S'uej jo si Ministër, po si prefekt kur kam qenë në Shkodrë, disa fjalë. Kur kám qenë në Shkodrë si prefekt, edhe prej N. Prefektit të Malsis së madhe kam marrë shkresa zyrtare e edhe verbalisht prej Krenve të Malsis e më kan tianë se këjo çashjtë po rrjedh tash tri vjet e kemi kuitue se po damtohami keqë. Këjo marreveshje si thashë nuk asht për dam t' onë, dhe kujtoi si mbas shpjegimevet qì dha delegati i jonë, se edhe n'anë të Sh. Naumit nuk ka ndonji ndryshim.

Qeverija ketë marrëveshje plotësisht e ka pranue se e shef të dobi shme e nuk ka ndonji send qì asht për dam t' onë, dhe prandej Ju lutem Z. S' uej të jepni vendimin t' Uej e të marrë fund mbassi Këshilla Ambassadoriale kà ndërmjetsue, dhe telegrami mbi pranimin mbas 15 ditësh, nuk asht bë tash, po shumë ma përparrë.

Z. E. FRASHERI: Me ngjanë se nuk po kuptohet qellimi i im. Unë e

pranoi, po due të mbyllë udhen e avenirit. Edhe Qeverija si e është çdo shqiptar lypet t' a pranojë me gjëzim.

Z. M. FRASHERI (Del. i Q. p. K. K.): Senatori i Korçës Z. Eshref Frasherit thotë due të mbyllë udhen e avenirit. Avenirin me ketë çashjtë nuk ka të bajë, dhe çashjtjet qì kanë marrë solucionin me kohë nuk kanë të bajnë hiq, dhe këjo nuk mund të bahet m'u cilë prap ato çashjtje qì kanë marrë fund. P. tregim çështja e kufinit me Qeverin Greke ka marrë formen definitive me kartë, me protokoll dhe Shteti Grek nuk mund t' a quej ketë si pretext e me kerkue revidimin e kufinit. Këjo ishte nji pjesë e kufinit qì ishte në konflikt, të dy Qeverinat hyene në marreveshje, dhe mbassi nuk ishin d'akord në pretdime, hyni në mes Konferanca e Ambasadorvet, caktoi nji vijë tranzacionale, bani nji vendim arbitri, të cilin Qeverija e jonë tue e pa të dobi shëm e pranoj. Pse të themi qì vendimi asht obligatoire (detyrshëm), ose vendim arbitri, çështja e avenirit nuk ka të bajë hiq, dhe mos kini frigë se frugat e para janë mbyllë.

Z. XH. YPI: Për fat të keq nuk bashkohem me delegatin t' onë, Z. Mehdi Frasherin e gjithashtu edhe me Z. Eshref Fresherin, Në asht se japoim vendim e kapercejmë kufinin, se Këshilla e Ambasadorvet thotë japo ketë vendim, në daçi pranonje në daçi jo. Unë proponoi edhe kerkoi qì të pranohet këtu sikur asht.

Z. S. BLLOSHMI: Këto fjalë që po bahan këtu, janë (jeu des mots), Ali

## BISEDIMET E DHOMËS SË DEPUTETVET

Hoxha, Hoxhë Alija. Aveniri Zotni nuk sigurohet me fjalë. Kur të na vinë tjeter gjâ, atëherë bisedojmë, sot kemi tjetër gja për bisedim. Këtu qe marrë një vendim dhe qe autorizue Qeverija me hyë në marreveshje me Qeverin Jugosllave për çashjen e kufinit t' one, dhe nuk qe autorizue të bajë 20 lloj marrëveshtje. Pra mos t'i përzitmë punët, se nuk qenë autorizuar qe autorizue t' e edhe sytë e atyne njerzvet qe menjnjë bukur e mirë, nuk mbyllen, si ç' thash me jeu de mot. Neve autorizuam Qeverin me ba ketë marreveshje, e cila u ba, dhe në qoftë se asht në favor t' onë do të pranohet. Neve po themi se asht në favor t' onë. Delegati i jonë na tha se nuk erdhi në një marreveshje të plete me Qeverin Jugosllave, dhe në mes hyni Këshilla e Ambasadorve e cila këshilloj të dy palët mos me u da prishë. Këshilla Ambasadorvet hyni në mes si plak dhe dau davanë.

Në e kuptova mirë, kështu na tha delegati i jonë. Prandëj mos t'a përzitmë çështjen tue thanë se asht një vendim i K. Ambasadoriale. Neve nuk mund të ndrojmë proces-verbalet e K. Ambasadoriale, se vendimet janë shkrue si vendime, dhe ky asht shkrue si një këshillë. Si mund t'a quejmë vendim, kur nuk asht vendim. Neve për s' dytit e kerkuem arbitrashin dhe ajo e pranoj.

Z. MEHDI FRASHERI: Zotni Bloshi mi tha se Qeverija e jonë kerkoi arbitragin e Konferencës s' Ambasadorvet. Jo Zotni, Qeverija nuk e kerkoi ketë

ndermjetsi, po Komisioni i Kufivet i cili i lajmoi se nuk u muerëm vesh, dhe neve nuk i thaime hajde na ujdis. Këshilla Ambasadoriale hyri vetveti si arbitër, se Qeverija e jonë ka kerkue aplikimin e vendimit qe kishte dhanë ma parë konferanca e Ambasadorvet. Ky asht një shqyrtim qe neve nuk e kerkuem, po me qenë se nuk u muerem vesht hyri në mes Konferenca si mirëdashese për me ndalue një konflikt.

Z. F. RUSI: Mbas fjalvet qe thotë Z. Mehdi Frasherit, proponimi i Z. Eshref Frasherit, me duket shumë i arësyeshëm. Ç' nevojë kje të ndryshohen artikujt e Statutit, kur rezulton çiltasi se Konferenca e Ambasadorvet ka hyë si arbitër pa pasë dhanë konsentrimin të dy Qeverit e interesume. Ky asht një vendim i detyrshëm (obligatoire), të cilin dahu t' a ratifikojmë të shtyem prej një nevojet.

Z. E. FRASHERI: Ketë radhë Z. Delegati e shpjegoi punen ma kjartë, tuke na thanë se kur të dy delegatët e Qeverivet t' interesume nuk mbeten d'akord, hyni në mes Komisioni i Kufivet. Komisioni i Kufivet pas raportit qe i ep, Këshilla Ambasadoriale cakton kufit. Kështu ka qenë gjere nashti. Prandëj pas mejtimit qe shfaqë Komisioni i Kufivet Këshilla Ambasadoriale prishi vendimin e parë, mori qesgine e fshiu vendimin e parë, dhe mori qesgine e bani një vendim të dyte qe mos të derdhej gjak në Balkan.

Z. S. VUCITERNI. Z. Kryetar! Me duket se po humbim kohë kot.